



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 709/3 Prot.

Tiranë, më 03.04 2026

**VENDIM**

Nr. 46 dt. 03.04 2026

**“PËR**

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 10 DATË 13.01.2026 TË SENATIT AKADEMIK DHE  
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NDRYSHUAR TË PROGRAMIT TË  
PËRBASHKËT MASTER I SHKENCAVE NË “SHKENCA SPORTIVE”, ME DIPLOMË  
TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETIT  
TË SHKENCAVE TË LËVIZJES” DHE UNIVERSITETIT “CARLO BO” TË URBINOS  
NË ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, Vendimit nr.48, datë 01.04.2026 të Rektoratit, Senati në mbledhjen e datës 03.04.2026

**VENDOSI:**

1. Shfuqizimin e Vendimit nr.13 datë 13.01.2026 të Senatit Akademik (bashkëlidhur).
2. Miratimin e marrëveshjes së ndryshuar të programit të përbashkët Master i Shkencave në “Shkenca Sportive” me Universitetin “Carlo Bo” të Urbinos në Itali, (bashkëlidhur).
3. Nisjen e procedurave për aplikim për hapjen e programit të përbashkët Master i Shkencave në “Shkenca Sportive” me Universitetin “Carlo Bo” të Urbinos në Itali.
4. Miratimin e pagesave për profesoratin e ftuar për mbulimin e shpenzimeve të transportit, fjetjes, dietës ditore si dhe pagesën për orë mësimdhënieje, sipas akteve rregullatore dhe marrëveshjes së miratuar.

5. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit.
6. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim FSHR-së, si dhe Drejtorisë Së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof. Dr. Agron KASAPI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 87/4 Prot.

Tiranë, më 13.01 2026

V E N D I M

Nr. 10 dt. 13.01 2026

“PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT  
“MASTER I SHKENCAVE” NË ‘SHKENCA SPORTIVE’ ME DIPLOMË TË  
DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI I  
SHKENCAVE TË LËVIZJES DHE UNIVERSITETIT TË URBINOS “CARLO BO”,  
ITALI”

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në LAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7, 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, Senati në mbledhjen e datës 13.01.2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes për hapjen e programit të përbashkët “Master i Shkencave” në “Shkenca Sportive”, me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe Universitetit të Urbinos “Carlo Bo” (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit.
3. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim FSHL-së, si dhe Drejtorisë Së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

